



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Ilir Rusi):

- 1.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
- 1.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- 1.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Valbona Bala, Eksperte (EËMI-NL)

6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Ilir Rusi):

1.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;

1.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;

1.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 26 prill.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkohet vendimmarrje për 17 çështje. Tre çështjet e para janë çështje shumë të rëndësishme, se kanë të bëjnë me zbatimin e hartës së re gjyqësore. Më datë 1 maj fillon zbatimi i fazës së dytë të hartës

gjqësore që prek gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, shkalla e parë, dhe për të cilat kërkohet vendimmarrje lidhur me ristrukturimin e stafit të këtyre gjykatave.

Pa humbur kohë ia japim fjalën z. Ilir Rusi, i cili është edhe kryetari i Grupit të Punës për zbatimin e hartës së re gjyqësore, i cili do të relatojë aktet përkatëse.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Si Kryetar i Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Tropojë dhe Pukë, paraqes këtë relacion përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me transferimin e kancelarëve të këtyre gjykatave.

Në zbatim të vendimit nr. 162, datë 06.04.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”, vendimit nr. 168, datë 06.04.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë” dhe vendimit nr. 169, datë 06.04.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë”, komisionet përkatëse të ristrukturimit, zhvilluan mbledhjen e parë më datë 12.04.2023, në të cilën u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, në kuadër të riorganizimit të rretheve gjyqësore.

Në mbledhjen e datës 12.04.2023, Komisionet e Ristrukturimit të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Tropojë dhe Pukë në zbatim të akteve ligjore në fuqi, morën në shqyrtim dhe vlerësuan sistemimin e kancelarëve në detyrë të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Tropojë dhe Pukë, referuar vakancave të mëposhtme:

- Kancelar në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Dibër,
- Kancelar në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Kukës,
- Kancelar në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sipas propozimeve të kryetarëve/zëvendëskryetarëve të gjykatave respektive, si dhe shprehjes së opinionit të kancelarëve, u propozua si më poshtë:

Transferimi i përhershëm të Kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat znj. {...}, nga pozicioni Kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pozicionin Kancelare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Transferimi i përhershëm të Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë z.

{...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në pozicionin Kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Transferimi i përhershëm të Kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë znj. {...}, nga pozicioni Kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pozicionin Kancelare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Komisionet e Ristrukturimit të gjykatave të rrethit gjyqësor Mat, Tropojë dhe Pukë, me vendimet nr. 2355/2, nr. 2348/2 dhe nr. 2341/2, vendosën t'i propozojnë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

-Transferimin e përhershëm të znj. {...}, nga pozicioni Kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pozicionin Kancelare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

-Transferimin e përhershëm të z. {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në pozicionin Kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Transferimin e përhershëm të znj. {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pozicionin Kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Komisioni i Ristrukturimit (konkretisht unë si Kryetare) ka mbajtur korrespondencën përkatëse me Këshillin e Lartë Gjyqësor i cili ka bërë edhe njoftimin e kancelarëve në lidhje me vendimin propozues të Komisionit të Ristrukturimit. Gjithashtu nga ana e Këshillit është bërë komunikimi i tyre me shkresë zyrtare, me postë elektronike, dhe njëkohësisht kanë ardhur konfirmimet e pranimit të këtyre vendimeve propozuese nga ana e kancelarëve të përmendur më sipër, në lidhje me transferimin e tyre përkatësisht në gjykatat e rrethit gjyqësor Mat, në Kukës dhe Shkodër.

Gjithashtu janë hartuar edhe projektvendimet përkatëse të cilat do doja t'i referoja.

Vazhdojmë me projektvendimin e parë në lidhje me transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

1. Zonja {...}, aktualisht kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Mat, transferohet në mënyrë të përhershme kancelare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi zonjës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Naureda Llagami: E hedhim në votim projekt-aktin?

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet akti sipas propozimit.

Vazhdojmë tek relatimi i aktit tjetër.

Ilir Rusi: Është i njëjti relati siç e bëra në mënyrë kumulative, por tani është projektvendimi përkatës.

1. Zoti {...}, aktualisht kancelar në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, transferohet në mënyrë të përhershme kancelar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi zotit {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: E hedhim në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër z. Rusi.

Ilir Rusi: Po!

1. Zonja {...}, aktualisht kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, transferohet në mënyrë të përhershme kancelare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi zonjës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: E hedhim në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet dhe projekt-akti.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Alban Toro):

- 2.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- 2.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- 2.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
- 2.4 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
- 2.5 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relator z. Alban Toro):
 - 2.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
 - 2.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
 - 2.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër;
 - 2.4 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
 - 2.5 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve edhe këto të Komisionit të Ristrukturimit, që do të relatohen nga zoti Toro.

Alban Toro: Atëherë, në zbatim të vendimeve nr.164, 165 dhe 167, datë 06.04.2023 “Për Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Përmet dhe Pogradec”, Komisionet i Ristrukturimit në funksionalitet të tyre, zhvilluan mbledhjet përkatësisht më datë 11.04.2023, sipas përbërjeve respektive, pranë ambienteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të nevojave të punës dhe qëllimit, në të cilat u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, në kuadër të riorganizimit të rretheve gjyqësore, të cilat vijuan në datën 13.04.2023 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, datën 14.04.2023 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier si dhe në datën 19.04.2023 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Në mbledhjet respektive të datës 11.04.2023, 13.04.2023, 14.04.2023 dhe 19.04.2023 Komisionet e Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, në përputhshmëri me pozicionet vakante të kancelarit në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, por, edhe pozicioneve vakante të trajtuara me dispozita të ligjit për shërbimin civil, në gjykatat e shkallës së parë, vendosën të propozojnë sistemimin e kancelarëve pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, si më poshtë:

- Znj. {...}, nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë – mbështetur edhe në faktin e vakancës së pozicionit vakant Kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në cilësinë e gjykatës e cila i nënshtrohet procesit të riorganizimit;

- Znj. {...} nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (në cilësinë e gjykatës pritëse), në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

- Z. {...}, nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në pozicionet vakante pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier: Shef Sektori, Sektori i Koordinimit të Zyrës së Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, Shef Sektori, Sektori i IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun.

- Znj. {...} nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (në cilësinë e gjykatës pritëse), në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;

- Znj. {...}, nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pozicionet vakante pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër: Shef Sektori, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.

Sa më sipër, në mënyrë unanime, Komisioni i Ristrukturimit, pas propozimeve të kryetarëve/zëvendëskryetarëve të gjykatave respektive dhe shprehjes së opinionit personal të kancelarëve, por në vëmendje kriteri i largësisë së vendbanimit me vendin e punës me vendimin nr. {...} prot., datë 13.04.2023, nr. {...} prot., datë 14.04.2023 dhe nr. {...} prot., datë 19.04.2023, miratoi propozimet e transferimit të përhershëm të kancelarëve në detyrë.

Komisionet e Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, duke ushtruar funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimet respektive, si dhe nga ana e strukturave funksionale pranë KLGJ-së është kryer njoftimi i Kancelarëve lidhur me propozimet konkrete për sistemim.

Kancelarët në detyrë, brenda afateve ligjore, kanë shprehur në rrugë elektronike apo zyrtare mendimin e tyre, me konkretisht:

- Znj. {...}, e cila ishte propozuar për sistemim, në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë – ka shprehur dakordësinë;

- Znj. {...} propozuar për sistemim në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier – ka shprehur dakordësinë;

- Z. {...}, propozuar për sistemim në pozicionin Shef Sektori, Sektori i Koordinimit të Zyrës së Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë, apo Shef Sektori, Sektori i IT,

Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka shprehur refuzimin;

- Znj. {...} propozuar për sistemim në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë - ka shprehur dakordësinë;

- Znj. {...}, propozuar për sistemim në pozicionin vakant Shef Sektori, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë – shpreh refuzimin.

Kështu që në lidhje me kancelarët që nuk kanë pranuar të sistemohen në një pozicion tjetër të ngjashëm në gjykatat pritëse është përgatitur një draft me anë të së cilës ju propozohet, duke qenë që funksioni i kancelarit është kompetencë e Këshillit, kam përgatitur dy drafte projektesh, për të cilën ju propozohet sipas dispozitivit në vijim:

Në lidhje me zonjën {...}:

1. Transferimin e përhershëm të znj. {...}, aktualisht në pozicionin kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pozicionin kancelare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi kancelares zonjës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Ndërkohë, ky propozim vjen duke marrë për bazë pikërisht parashikimet e nenit 6, aktit nënligjor të miratuar nga KLGJ-ja, i cili ka për bazë përvojën profesionale dhe arsimimin, në kushtet kur zonja në fjalë, në raport me kandidatin zotin {...} disponon 12 vite, 6 muaj, 12 ditë si kancelare (pra është marrë përvoja specifike), ndërkohë që ish-kancelari i Lushnjës ka 9 vite eksperiencë, 11 muaj, 27 ditë në detyrën e kancelarit. Duke marrë për bazë këtë kriter është kryer ky propozim, duke shtuar edhe faktin që bëhet fjalë për një kandidate e cila ka kritere specifike apo arsye të forta familjare të cilat janë marrë në konsideratë që vijnë nga përbërja familjare e saj.

Ndërkohë që për zotin {...}, aktualisht propozoj që t'i jepen në dispozicion disa pozicione të ndryshme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për t'i ofruar me qëllim që të mund të përzgjedhë atë që ai mund ta shikojë më interesante.

Këto dy janë propozimet që kanë lidhje me sistemimin e dy kancelarëve, për të cilët ka qenë e pamundur të procedohej për shkak të refuzimit të tyre në lidhje me atë çka është propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi diskutime mbi propozimin e ardhur?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, duke konsideruar propozimin e bërë nga zoti Toro që kancelarët në detyrë të gjykatave pritëse Korçë, Gjirokastrë dhe Fier vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë dhe nuk është e nevojshme që të kemi një akt të dytë për transferimin e tyre, pra ata janë kancelarë në detyrë të gjykatave përkatëse edhe pas organizimit në datën 1 maj, unë kam diskutim vetëm për sa i përket propozimit të bërë prej tij (sepse ndoshta nuk janë propozime të Komisionit të Ristrukturimit, janë propozim si anëtar, apo jo), lidhur me pozicionimin e kancelarit në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë sot dhe kancelares në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet sot.

Duke qenë se në rend dite kemi në fakt Lushnjën të parën, po e filloj me Lushnjën. Për pozicionimin e dy kancelarëve unë mendoj që Këshilli duhet të mbajë të njëjtin standard që mbajti për pozicionimin e dy kancelarëve të gjykatave të apeleve në momentin e riorganizimit të gjashtë apeleve në një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, ku dy kancelarë të cilët ishte e pamundur të pozicionoheshin në pozicionin kancelar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm apo edhe në gjykatat e rretheve brenda juridiksionit të tyre, u propozuan për sistemim duke zbatuar kriter të parë kriterin e 45 km, pra afërsisë me territorin e gjykatës më të afërt ku nuk kishte kancelarë në detyrë. Duke zbatuar të njëjtin standard mendoj që në këtë rast jemi para faktit që kancelarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë duhet ta sistemojmë në pozicionin e kancelarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat; dhe për sa i përket zonjës {...} pastaj mbetet për t'u pozicionuar duke qenë se nuk ka më në

gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të afërsisë së saj, pozicion kancelari bosh, në një pozicion siç është përmendur edhe këtu në relacion, që është Shef i Sektorit të IT-së, Teknologjisë së Informacionit. Është Shef Sektori, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve. Është përmendur edhe në relacion kjo gjë, është një pozicion bosh në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga Albani për respektimin e këtyre kriterëve të kualifikimit apo jo, në fakt ka një dukje që zonja {...} vërtetë ka më shumë vite si kancelare por ka më pak vite si juriste, dhe anasjelltas për zotin {...}, por këto kriterë do të futen në funksionim ose do të fillojnë të vlerësohen në rastet kur nuk do të respektohet distanca prej 45 km. Ne kemi mbajtur qëndrimin në rastin e kancelares së apelit Durrës dhe të apelit Gjirokastër që pozicionimin e kancelares së apelit Durrës e bëmë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, për shkak të 45 km dhe jo për shkak të përvojës profesionale sepse po të ishte anasjelltas duhet të kishte përparësi kancelarja e apelit Gjirokastër.

Për këtë arsye, propozimi im është që zoti {...} të transferohet në pozicionin e kancelarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe zonja {...}, të ruajë statusin e kancelarit në detyrë (sepse e ruan këtë status) dhe të transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Teknologjisë së Informacionit, sipas përmbajtjes së relacionit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi dy propozime.

Kalojmë në propozimin e parë që është propozimi i relatorit i cili propozon që zonja {...} të pozicionohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat si kancelare në detyrë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i z. Toro.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i zonjës Ukperaj që zoti {...} të pozicionohet kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord, për sa kohë propozimi tjetër u rrëzua nga Këshilli.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi i znj. Ukperaj.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek propozimi i radhës që ka të bëjë me transferimin e përhershëm të znj. {...}.

(Zonja Shehu shpreh një propozim tjetër lidhur me pozicionin e zonjës {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë zonja Shehu çfarë propozimi keni lidhur me sistemimin e zonjës {...}?

Marçela Shehu: Atëherë, përveç propozimit të ardhur nga zonja Ukperaj, unë do doja që kancelares në detyrë t'i vihej në dispozicion për të zgjedhur edhe pozicioni i Shefes së Sektorit, Sektori i Koordinimit të Zyrës së Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë,

pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për shkak të urgjencës do vlerësoja që pëlqimi apo mendimi t'i kërkohej sa më parë dhe çështja më pas të trajtohej po sot në mbledhje plenare.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, jemi dakord?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Duke qenë se unë bërë propozimin referuar pozicioneve të përmendura në relacion, duke qenë se ky është një propozim që është tek relacioni, shpreh dakordësinë me propozimin e zonjës Shehu.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord?

Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, stafi administrativ të komunikojë në këto momente me zonjën {...} me e-mail dhe ndërkohë që ne vijojmë shqyrtimin e çështjeve të tjera, të na komunikohet vullneti i zonjës {...}, për të lejuar Këshillin që të marrë vendim mbi caktimin e saj.

Shtyhet kjo çështje, për ta përfunduar në fund të çështjeve të tjera.

(Pas trajtimit të çështjeve numër 3 dhe 4 të rendit të ditës, dhe pas marrjes së vullnetit të znj. {...}, Këshilli i rikthehet trajtimit të çështjes.)

Naureda Llagami: Për të vijuar me çështjen, dëshiroj t'ju informoj që nga administrata u përcoll propozimi i bërë nga zonja Shehu lidhur me zonjën {...} dhe ajo na ka përcjellë në rrugë elektronike sa më poshtë që: Konfirmoj marrjen në dijeni dhe shpreh pëlqimin për pozicionin e propozuar.

Kështu që unë mendoj që mund të kalojmë në votimin e transferimit të zonjës {...} si kancelare.

Po, Marçela do e bësh me të njëjtin formulim.

Zonja Shehu, do e lexoni propozimin e aktit?

Marçela Shehu: Atëherë, zonja {...} ruan statusin e kancelares në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Shefes së Sektorit, Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, Protokoll-Arkiv, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi zonjës {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e zonjës Shehu.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e zonjës Shehu lidhur me zonjën {...}.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relatore znj. Marçela Shehu):

- 3.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- 3.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- 3.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
- 3.4 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- 3.5 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EËMI-NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Ristrukturimit (relatore znj. Marçela Shehu):
 - 3.1 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
 - 3.2 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - 3.3 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
 - 3.4 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
 - 3.5 Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështjet e tjera të rendit të ditës, që edhe këto janë

në kuadër të hartës gjyqësore. Bëhet fjalë për transferimin e kancelarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Në zbatim të vendimeve nr. 163, 166 dhe 170, datë 06.04.2023 për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Kurbin dhe Krujë, Komisioni i Ristrukturimit, zhvilloi mbledhjet përkatësisht më datë 11.04.2023, sipas përbërjeve respektive, në të cilat u diskutua mundësia e sistemimit të kancelarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, në kuadër të procesit të ristrukturimit për shkak të riorganizimit të rretheve gjyqësore.

Në mbledhjet e datës 11.04.2023, Komisioni i Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, në përputhshmëri me pozicionet vakante të kancelarit në gjykatat e rretheve gjyqësore, por, edhe pozicioneve vakante të trajtuara me dispozita të ligjit për shërbimin civil, në gjykatat e shkallës së parë, unanimisht, vendosi të propozojë sistemimin e kancelarëve pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, si më poshtë:

Bëhet fjalë për dy kancelarët, konkretisht për zonjën {...} dhe z. {...}, duke qenë se kancelarët e tjerë znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} vijojnë referuar vendimit kuadër, vijojnë ushtrimin e detyrës së kancelarit në detyrë konkretisht pranë gjykatave ku ata aktualisht e ushtrojnë këtë detyrë.

Në lidhje me dy kancelarët e tjerë, propozimi i Komisionit të Ristrukturimit është si më poshtë:

Zoti {...}, nga pozicioni Kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në pozicionin Shef Sektori, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhshmëri edhe me kriteret arsimore;

Zonja {...}, nga pozicioni kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në përputhshmëri edhe me kriteret e saj arsimore, konkretisht iu ofruan dy pozicione: Shef Sektori, Sektori i Koordinimit të Zyrës së Shërbimit dhe Protokoll/Arkivë në Gjykatën

e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Kryesekretare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Komisionet e Ristrukturimit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimet propozuese respektive.

Më poshtë keni të listuar edhe të dhënat për secilin prej kancelarëve (janë të detajuara në relacion), si dhe pozicionet aktualisht vakante.

Të dy kancelarët, ju bëj me dije se kanë dhënë pëlqimin për të ushtruar, konkretisht: z. {...}, ka pranuar të ushtrojë detyrën e Shefit të Sektorit, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me rezervën e ruajtjes së statusit të kancelarit në detyrë;

E njëjta gjë edhe për zonjën {...} e cila ka pranuar propozimin për të ushtruar detyrën e Kryesekretares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke kërkuar edhe ajo që Këshilli i Lartë Gjyqësor t'i ruajë statusin e kancelarit në detyrë.

Bazuar sa më sipër, janë paraqitur sot për shqyrtim dy projektvendime mbledhjes plenare, konkretisht, propozimi i parë për zotin {...} është propozuar që:

1. Zoti {...}, të ruajë statusin e kancelarit në detyrë dhe të transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Shefit të Sektorit, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Pra ky është formulimi i projektvendimit për z. {...}.

Ndërsa për zonjën {...}:

1. Zonja {...}, ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Kryesekretares, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Efektet e këtij vendimi, për të dyja projektvendimet janë parashikuar në datën 01.05.2023 dhe njoftimi i të dy kancelarëve në detyrë, pra njoftimin e këtij vendimi zotit {...} dhe zonjës {...}, dhe gjykatave respektive.

Ky është edhe propozimi që unë i paraqes sot mbledhjes plenare, duke u bazuar si

në propozimin e Komisionit, ashtu edhe në dhënien e pëlqimit dhe të mendimit të kancelarëve në detyrë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu!

Kalojmë në projekt-aktin e parë që ka të bëjë me sistemimin e zotit {...} i cili aktualisht është Kancelar në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe që do të transferohet në pozicionin e Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke ruajtur statusin.

Marçela Shehu: Nëse mendoni, mund ta lexoj projektvendimin e plotë?

Naureda Llagami: Po, edhe një herë.

Marçela Shehu: Atëherë, projektvendim “Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në dispozitat përkatëse, vendosi:

1. Zoti {...}, ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Shefit të Sektorit, Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi z. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, e hedhim në votim propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i ardhur nga zonja Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Projektvendim “Për transferimin e përhershëm të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë” – znj. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar dispozitave përkatëse, vendosi:

1. Zonja {...}, ruan statusin e kancelarit në detyrë dhe transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin e Kryesekretares, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.05.2023.

3. Njoftimin e këtij vendimi znj. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i zonjës Shehu.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me raportin vjetor.

Ju e dini shumë mirë që Këshilli i Lartë Gjyqësor mbart detyrimin që të raportojë përpara Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit dhe është detyrim i Këshillit që këtë raport t’ia përcjellë Kuvendit para datës 1 maj.

Raporti është produkt i një grupi pune, të cilët unë i falënderoj për punën që kanë bërë. Raporti është një sintezë e të gjithë raporteve të komisioneve dhe që janë të publikuara edhe në faqen tonë elektronike, gjithashtu është edhe një sintezë e gjendjes së

sistemit, duke marrë parasysh indikatorët e performancës që ne matim çdo tre muaj mbi situatën e sistemit dhe që janë analizuar më poshtë.

Raporti është i përbërë nga 5 kapituj, duke pasqyruar veprimtarinë dhe rezultatet e Këshillit në disa dimensione, të shprehura midis shifrave, analizës së plotë narrative apo pjesëzave dedikuara gjetjeve më të rëndësishme për çdo kapitull. Në terma të përgjithshëm, çështjet që trajtohen në raport janë: -Veprimtaria e vetë institucionit; menaxhimi i burimeve; - zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit gjyqësor; - situata e sistemit gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përmbyllur vitin e tij të katërt të funksionimit të qeverisjes së gjyqësorit.

Gjatë vitit 2022, mund të përshkruhet si një vit më i mirë se ai i lënë pas, kjo për faktin se ai përkon me zhdukjen graduale të pandemisë globale. Megjithatë, sfidat për sistemin gjyqësor nuk kanë përfunduar kur bëhet fjalë për mungesën e burimeve njerëzore nëpër gjykata, veçanërisht më të prekura gjykatat e apelit, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Vlen të theksohet se, Këshilli ka hyrë tashmë në një fazë konsolidimi ndaj dhe vendimmarrjet e tij janë vazhdimësi e strategjive, strukturave apo vendimmarrjeve të ndërmarra ndër vite. Gjatë këtij viti evidentohen disa zhvillime të rëndësishme pozitive, që unë dua t'i përmend shkurtimisht:

E para është që kemi zhvilluar rreth 114 mbledhje plenare nga të cilat 45 mbledhje për caktim gjyqtarësh me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore dhe janë miratuar rreth 562 vendimeve.

Miratimi i Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për sistemin gjyqësor në Shqipëri për vitin 2022 – 2024 si një vazhdimësi e misionit dhe vizionit të tij strategjik për arritjen e ekselencës gjyqësore.

Miratimi i Planit të ri të Komunikimit për gjykatat, i shoqëruar me një sërë aktesh me qëllim rritjen e transparencës dhe një komunikim më të mirë e cilësor me publikun dhe median.

Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 16 anëtarë dhe hapjen e garës, për 4 vendet e mbetura vakante, përmes procedurave së ngritjes në detyrë të magjistratëve.

Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”. Hartimin e projekt-akteve të nevojshme për fillimin e zbatimit të hartës së re, faza e parë për gjykatat e apelit.

Vazhdimi i zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore me qëllim garantimin e profesionalizimit, qëndrueshmërisë dhe integritetit në ushtrimin e funksioneve publike. Shtimin e stafit administrativ dhe mbështetjen teknike në sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykatat e apelit; Shtimin e stafit administrativ me 204 pozicione në total (124 pozicione nëpunës civilë gjyqësorë dhe 80 pozicione punonjës të tjerë gjyqësorë) në gjykatat e të gjitha niveleve; Ndërsa në gjykatat e apelit për vitin 2022 shtimi i stafit administrativ rezulton të jetë me 46 pozicione (23 nëpunës civilë gjyqësorë dhe 23 punonjës të tjerë gjyqësorë); Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të 2 kancelarëve; Standardizimin dhe përmirësimi i sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, konkretisht kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, përmes miratimit të rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”.

Përgatitjen dhe rekrutimin e gjyqtarëve të rinj duke: Përcaktuar në 45 numrin e kuotave për magistratë “profili gjyqtar”, dhe 10 numrin e kandidatëve për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2021-2022; Kryerjen e verifikimeve të kritereve dhe kushteve formalo-ligjore si dhe pasurisë dhe figurës për 50 kandidatë.

Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar duke: Depozituar pranë KPK-së 30 raporte të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 150 dosje gjyqësore për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar; Nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë, dorëzuar pranë KPK-së rreth 379 raporte të analizimit të aftësive profesionale, duke përmbyllur 79% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor duke zhvilluar 5 procedimeve disiplinore, prej të

cilave u konkludua në: 2 masa “Pezullimi nga detyra”; 2 procedime disiplinore janë përmbyllur me vendime jo-përfundimtare; 1 procedim disiplinor është ende në vijim.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, Këshilli ka: Trajtuar 744 kërkesa duke caktuar 920 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme; Përfshirë në skemë delegimi 10 gjyqtarë dhe ka transferuar me pëlqim 9 gjyqtarë; Vijimin e vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar 27 raporte vlerësimi. Në 3 vite veprimtari janë hartuar dhe miratuar 107 raporte vlerësimi për 60 gjyqtarë duke vlerësuar rreth 1/3 e gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë.

Rritja e transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale, ICMIS dhe ARKIT: Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 686 kërkesave për mbështetje teknike nga të gjithë gjykatat; Përfundimi me sukses i migrimit i të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit për Juridiksionin e Përgjithshëm, mundësuar në kuadër të zbatimit të hartës gjyqësore; Ngritja e infrastrukturës së re fizike (implementimi i serverit dhe *storage*) e cila do të mundësojë administrimin dhe përpunimin e të gjitha çështjeve të Gjykatës së Apelit për Juridiksionin e Përgjithshëm; Përcaktimi i rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short, marrja e masave të nevojshme si dhe testimi i këtij mekanizmi për të mundësuar realizimin me sukses në praktikë.

Sigurimi i mirëfunksionimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe miratimi i të gjitha akteve të nevojshme në këtë drejtim, përfshirë miratimin e strukturës dhe organikën e saj.

Vijimin e një qasjeje transparente komunikimi publik në mënyrë sa më profesionale dhe cilësore. KLGJ-ja në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit gjatë vitit 2022, ka trajtuar 24 kërkesa për informacion, duke iu përgjigjur, brenda një afati të arsyeshëm, të gjithë kërkuessve. Popullimi, me informacion dhe në kohë të arsyeshme, i faqes zyrtare të internetit të KLGJ-së, me të gjitha materialet dhe vendimmarrjet e Këshillit.

KLGG-ja ka vijuar bashkëpunimin e brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitete, takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile.

Me qëllim rritjen profesionale të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ, por edhe forcimit e ruajtjes së një mjedisi pune motivues, janë trajnuar 220 gjyqtarë që ushtrojnë efektivisht detyrën, 13 punonjës të KLGG-së, 103 nëpunës civilë gjyqësorë dhe kjo në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ASPA-n, projektet e asistencës së huaj.

Lidhur me analizën e sistemit dhe gjetjet:

Për të pasqyruar një panoramë sa më realiste të indikatorëve kryesorë të sistemit dhe për të bërë të mundur krahasime sa më domethënëse me vitet e mëparshme, analiza e gjendjes së gjyqësorit këtë vit, është bërë e kategorizuar sipas juridiksionit dhe nivelit të gjykatave, në përputhje të plotë me Udhëzuesin për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore (miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në 2021-in).

Kështu, gjatë vitit 2022, sistemi gjyqësor është përballur me një ulje minimale të ngarkesës së punës, ku numri total i çështjeve në shqyrtim në vitin 2022 është 0.4% më i vogël se në vitin 2021.

Qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave duke sjellë një ulje prej 12% të çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2022, krahasuar ajo me vitin paraardhës.

Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70% (25 nga 38 gjykata), ndërsa në nivel kombëtar vetëm 56% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2022.

Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 228 gjyqtarë ose 8.2 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është më pak se 40% e normës evropiane (22.2 gjyqtarë për 100.000 banorë).

Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve, mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi është rritur duke shënuar një normë prej 104% (krahasuar me normën mesatare 68% në 2021) me qëllim mbajtjen nën kontroll të rritjes së stokut, tentativa të cilat nuk kanë sjellë rezultat pasi shënohet një rritje e stokut prej 31% të çështjeve në pritje të gjykimit në rang vendi.

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2022, ka qenë pothuajse 561 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 25 çështje nga viti i kaluar që ka qenë 536 për gjyqtar.

Analiza eidenton pothuaj të njëjtin trend performance me atë të vitit të shkuar (me pak përmirësime) për shumicën e indikatorëve të matur dhe që në shumicën e rasteve ka ardhur si pasojë e numrit të ulët të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor si rrjedhojë e ecurisë së procesit të rivlerësimit kalimtar.

Vlen të theksohet se raporti midis numrit të gjyqtarëve faktik për 100 mijë banorë është ende i ulët në krahasim me atë të mesatares evropiane. Numri prej 8.16 gjyqtarëve efektivisht në detyrë për 100 mijë banorë, ndonëse ka pasur një rritje nga 7.91 krahasuar me një vit të mëparshëm, mbetet shumë larg mesatares evropiane prej 22.2 gjyqtarë për 100 mijë banorë.

Ndërkohë, numri i stafit jogjyqtar për 100 mijë banorë sipas organikës në fakt është 37.84, kundrejt mesatares evropiane për vitin 2022 prej 55.5. Edhe këtu kemi një rritje të vogël nga 36,7 për 100 mijë banorë në vitin 2021 në 37,8 për 100 mijë banorë në vitin 2022.

Më në detaj, treguesit e analizës së sistemit gjyqësor, sipas kategorive dhe juridiksioneve, mund të përmbliidhen si vijon:

Gjykata e Lartë, gjatë vitit 2022 ka funksionuar me 70% të gjyqtarëve dhe 74% të administratës gjyqësore të parashikuar në organikë. Për rrjedhojë ajo ka arritur të evadojë 6335 çështje civile, administrative dhe penale si dhe të dyfishojë normën e likuidimit të çështjeve civile dhe katërfishojë normën e likuidimit të çështjeve penale. Viti 2022 u përmbyll me një stok të reduktuar me 12% krahasuar me 1 vit më parë. Në 1 janar 2023, në Gjykatën e Lartë presin të shqyrtohen 31,827 çështje (backlog-u i vitit 2022).

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO) ndonëse ka funksionuar me 72% të gjyqtarëve dhe nuk kanë pasur ngarkesë të lartë të çështjeve, nuk ka arritur të përmirësojë performancën, krahasuar me vitin paraardhës. Kjo për shkak të kompleksitetit të natyrës së çështjeve që shqyrton kjo gjykatë. Vlen të theksohet se gjatë vitit raportues, ajo ka ulur me 52% rendimentin mesatar për gjyqtar për shkak të stokut të ulët të çështjeve të mbartura (10% e

ngarkesës totale) dhe ka një normë pozitive të likuidimit të çështjeve në masën 97%. Për sa i përket kohëzgjatjes mesatare për likuidimin e çështjeve, ajo ka qenë rreth 40.8 ditë.

Për sa i përket Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, evidentohet se rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2022, në krahasim me vitin paraardhës ka sjellë rritjen e tërësisë së treguesve të efijencës në gjykatë. Vlen të theksohet se norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 101% dhe koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) është 26.6 ditë.

Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, kanë evidentuar një përkeqësim për sa i përket treguesve të efijencës gjatë vitit 2022. Ka rritje të backlog-ut të çështjeve me 24% më tepër krahasuar me vitin 2021. Ndërkohë që ritmet e gjykimit në çështjet penale figurojnë më pozitive për çështjet civile, koha mesatare e nevojshme për shqyrtimin e çështjet ndryshon në varësi të gjykatës. Në dy gjykata të apelit, në Gjirokastër dhe Shkodër çështjet civile gjykohen brenda afatit të arsyeshëm, ndërsa në 4 gjykatat e tjera shqyrtimi civil i kalon afatet e arsyeshme për dhënien e vendimit. Problematike paraqitet gjendja në Gjykatën e Apelit Tiranë ku treguesi DT (i kohës së nevojshme që duhet për shqyrtimin e çështjeve) shënon vlerën 5995.3 ditë ose 16.4 vite.

Gjykatat e shkallës së parë, juridiksioni i përgjithshëm, ngarkesa totale e çështjeve të pashqyrtuara nga viti 2021 (backlog-u) është 36,590 çështje (28% më shumë krahasuar me vitin paraardhës), nga të cilat 53% (19,374 çështje) janë të Gjykatës së Tiranës. Këto gjykata kanë funksionuar me 70% të gjyqtarëve të parashikuar dhe treguesit e efijencës janë përkeqësuar duke shënuar:

- Uljen e normës së likuidimit të çështjeve për të dyja kategoritë e çështjeve. Ajo është mesatarisht 95% për çështjet civile dhe po ashtu për çështjet penale.

- Rritjen e treguesit DT (koha e nevojshme për përfundimin e një çështjeje në ditë) dhe zgjatjen e afateve të nevojshme për shqyrtimin e çështjeve. Një çështje civile gjykohet në shkallë të parë mesatarisht rreth 168 ditë, ndërsa një çështje penale për 98 ditë. Megjithatë, vlen të theksohet se gjykimi i çështjeve penale dhe civile në shkallë të parë realizohet brenda afateve të arsyeshme ligjore, në të gjitha gjykatat e vendit.

Gjykata Administrative e Apelit ka filluar vitin 2022 me një backlog prej 21% më shumë se viti paraardhës. Treguesit e efijencës kanë shënuar një përmirësim të lehtë,

ku vlen të theksohet se norma e likuidimit të çështjeve (CR) është rritur nga 21% në vitin 2021, në 24% në vitin 2022. Ndërkohë, ka vijuar të thellohet problematika e kohës së nevojshme për likuidimin e çështjeve. Në krahasim me një vit më parë, afat kohor mesatar prej 8680.4 ditë, që do të thotë 14.6% më gjatë se në vitin paraardhës. Ky tregues shfaq qartë gjendjen problematike në të cilën ndodhet kjo gjykatë.

Gjykatat administrative të shkallës së parë, evidentohet që backlog-u i çështjeve të mbartura në fillim të 2022 është rritur me 12% (backlog-u gjendet kryesisht në gjykatën e Durrësit 35% dhe në gjykatën e Tiranës 27%). Gjykimi në këtë grup gjykatash është kryer nga 73% e gjyqtarëve të parashikuar në organigramë, duke shënuar një normë likuidimi të çështjeve nën 100% në katër gjykata (Durrës, Gjirokastrë, Korçë dhe Tiranë). Përjashtuar Durrësin, gjykimi në gjykatat e tjera të këtij grupimi kryhet brenda afate të arsyeshme, me një tregues DT mesatar prej 260.9 ditë.

Angazhimet e KLGJ-së për vitin 2023:

Në kuadrin e kryerjes së bilancit të fundvitit 2022 dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Këshilli Lartë Gjyqësor, do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim dhe përgjatë vitit 2023 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Vijimin e hartimit të kuadrit nënligjor të nevojshëm për të gjitha proceset dhe çështjet me fokus planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, ato që lidhen me veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave dhe vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor me qëllim krijimin e një administrate të qëndrueshme.

3. Zbatimin në praktikë të hartës gjyqësore, sipas fazave të përcaktuara në këtë projekt:

Riorganizimin e 6 gjykatave (që është kryer).

Riorganizimin e 22 gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm (që kryhet në 1 maj 2023).

Riorganizimin e 6 gjykatave të posaçme administrativ të shkallës së parë në 2 gjykata, të cilat fillojnë veprimtarinë më 1 korrik.

4. Thellimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës si për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve në detyrë, me qëllim plotësimin e vendeve vakante në sistem dhe uljen e çështjeve të prapambetura.

5. Vijimin e vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kalendarin e përcaktuar nga KLGJ-ja si dhe emërimin dhe promovimin e tyre si në bazë të nevojave të sistemit dhe në respektim të plotë të të drejtave të kandidatëve në këto procese.

6. Sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm me qëllim identifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe financiare.

7. Forcimin e bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të teknologjisë së informacionit.

Kërkesat ndaj kuvendit:

Si gjithmonë ne kemi kërkesa për miratimin e ndryshimeve ligjore, që në fakt është i disati vit që ne po i presim, por që nuk kanë ardhur. Dhe e dyta, mbështetjen financiare në investime për rikonfigurimin dhe shpërndarjen gjeografike që kanë gjykatat sipas hartës së re gjyqësore duke dhënë prioritetet tona.

Shkurtimisht ky ishte raporti vjetor për Këshillin e Lartë Gjyqësor, për vitin 2022.

Nëse keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.
(*Miratohet.*)

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

(Pas disa minutash pushim rifillon mbledhja nëpërmjet platformës “online” nën drejtimin e zëvendëskryetarit, z. Rusi.)

Ilir Rusi: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Ndërkohë, me këtë material voluminoz, të gjithë anëtarët e

Këshillit të Lartë Gjyqësor janë njohur, dhe do ftoja relatorin përkatës për të na bërë një paraqitje sintetike të këtij materiali me piketat kryesore në lidhje me buxhetin.

Z. Haxhiu!

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka përfunduar dokumentin e kërkesave buxhetore për sistemin gjyqësor për periudhën 2024–2026 bazuar në legjislacionin “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Hartimi i dokumentit të projektbuxhetit afatmesëm 2024–2026 prezanton kërkesat për fonde buxhetore për sistemin gjyqësor, KLGJ, QTI dhe buxheti i gjykatave, për fazën e parë strategjike, duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të KLGJ–së.

Në funksion të përgatitjes së kërkesave buxhetore, përcaktohet misioni i njësisë publike, mision i cili është i lidhur ngushtësisht me vizionin e saj. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Planin Strategjik, ka të përcaktuar qartë: vizionin, misionin, vlerat, synimet dhe objektivat e tij.

Deklarata e misionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të përgatitjes së kërkesave buxhetore, PBA 2024–2026, është: Të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon ekselencë dhe meriton besimin e publikut.

Vizioni i KLGJ–së, është: Drejtësia në Shqipëri, do të arrihet, kur të gjithë qytetarët do të kenë besim se do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë përballë ligjit, nga një sistem gjyqësor i pavarur, etik dhe efikas.

Misioni i KLGJ–së është: Të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë, një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

Në funksion të misionit është edhe politika e programit buxhetor e cila është: Qeverisje, kontroll, monitorim dhe vlerësim i veprimtarisë së sistemit gjyqësor, nëpërmjet vendimmarrjes cilësore dhe zbatimit të praktikave më të mira në menaxhimin e

burimeve njerëzore dhe atyre financiare, në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duke u përqendruar në standardet më të mira, për të arritur një sistem gjyqësor ekselent.

Në funksion të politikës së programit është edhe qëllimi i politikës i cili është: Të punojnë për të ndërtuar një sistem gjyqësor profesional, efikas, llogaridhënës dhe novator, duke zbatuar praktikën më të mira ndërkombëtare, mbështetje dhe instrumente që përmirësojnë ofrimin e shërbimeve gjyqësore, efikasitetin e administrimit të gjykatave, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët.

Në vijim po parashtrijmë kërkesat buxhetore për sistemin gjyqësor, të detajuar sipas programeve buxhetore dhe artikujve kryesorë të shpenzimeve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e buxhetit në KLGJ, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e gjykatave dhe të teknologjisë së informacionit, ka përgatitur dokumentin përfundimtar të kërkesave buxhetore (PBA) për periudhën 2024 - 2026 për sistemin gjyqësor, faza e parë, duke u mbështetur në legjislacionin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në funksion të përgatitjes së programeve buxhetore afatmesëm.

Kërkesat buxhetore, për fazën e parë strategjike, janë përgatitur duke pasur parasysh si tavanet përgatitore të miratuara, si edhe historikun e realizimit të shpenzimeve sipas programeve, gjatë vitit buxhetor 2022 dhe në buxhetin e miratuar për sistemin gjyqësor për vitin 2023.

Tavanet përgatitore, janë miratuar me VKM nr. 195, datë 05.04.2023, të ndara në tre programe buxhetore.

Struktura e Programeve Buxhetore në grupin buxhetor “KLGJ” është si më poshtë:

– Programi 01110 – “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

– Programi 01140 – “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI).

– Programi 03310 – “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.

Kërkesa buxhetore, për vitin 2024, për të tre programet buxhetore, në total janë parashikuar në shumën prej 6,685,450 mijë lekë.

Theksojmë se kërkesat buxhetore të sistemit gjyqësor, të parashikuara për vitin 2024, janë më të larta se kërkesat buxhetore të sistemit gjyqësor, të parashikuara për vitin buxhetor 2023, që janë afërsisht 20% më shumë, rritje e cila vjen kryesisht nga rritja e shpenzimeve të personelit, si rrjedhojë e ndryshimit të pagës referuese të magjistratit (gjyqtar).

Kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor, për të tre programet buxhetore, krahasuar me tavanet përgatitore të miratuara, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme, që të gjithë ju e keni përpara.

Siç shikohet nga pasqyra në total, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 6,685,450 mijë lekë, ndërsa tavanet e përgatitur janë në shumën 3,885,650 mijë lekë, pra kërkesat buxhetore për vitin ushtrimor 2024, janë në masën 72% më të larta se tavani i miratuar ose në vlerë absolute janë në shumën 2,799,800 mijë lekë, më shumë se tavani i miratuar.

Kërkesat buxhetore për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, janë në masën 7 %, të totalit të sistemit gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, janë parashikuar në masën 0,2% e kërkesave të sistemit gjyqësor.

Pjesën më të madhe në kërkesat buxhetore e zë programi “Buxheti gjyqësor”, ku janë parashikuar në masën 92.8% të kërkesave buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor.

Kalojmë në një parashtrim të shkurtër sipas programeve buxhetore.

Programi 01110 – “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” –

Në këtë program, siç e përmendëm më sipër, përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këtë program është miratuare dhe pema e programit në funksion të programit buxhetor ku janë të përcaktuar drejt përshkrimi i programit, qëllimi i politikës së programit, objektivat e programit,

treguesit e performancës në nivel objektiv, produktet e programit sipas grup shpenzimet (shpenzime korrente ose shpenzime kapitale).

Kërkesat buxhetore për këtë program janë parashikuar në shumën 469,950 mijë lekë, pra janë parashikuar në shumën 143,800 mijë lekë, më shumë se tavanet buxhetore të miratuara, ndërsa shpenzimet kapitale janë në shumën 119,300 mijë lekë mbi tavanin e miratuar.

Shpenzimet korrente në shumën 335,650 mijë lekë, janë në shpenzime personeli, shpenzime operative dhe për transferta për buxhetet familjare dhe individët.

Në shpenzime personeli janë parashikuar në shumën 261,000 mijë lekë, të cilat janë në vlerën 24,500 mijë lekë mbi tavanin e miratuar. Kjo, ka ardhur për shkak të efektit të ndryshimit të pagës së magistratëve të cilët kryejnë funksionin pranë KLGJ-së, sipas vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

Për programimin e kërkesave buxhetore në shpenzimin e personelit “shpenzime paga” dhe “sigurime shoqërore” jemi mbështetur në buxhetin e miratuar për këtë artikull për vitin 2023 si dhe numrin e punonjësve prej 128 vetash për KLGJ-në i cili është i detajuar sipas pozicioneve dhe organigramës së institucionit të miratuar.

Në shpenzime operative, “Mallra dhe shërbime të tjera”, kërkesat janë parashikuar në shumën 73,150 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore janë hartuar duke pasur parasysh si referencë buxhetin e miratuar për këtë artikull, për vitin 2023, si edhe duke u mbështetur në nevojat e kërkesat e identifikuar në mënyrë analitike për çdo strukturë në KLGJ. Këto kërkesa kryesisht janë parashikuar të përdoren për nënartikullin “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, nënartikullin “Materiale dhe shërbime speciale”, nënartikullin “Shërbime nga të tretë”, nënartikullin “Shërbime transporti”, nënartikullin “Shpenzime udhëtimi”, nënartikullin “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”, nënartikullin “Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale”, si dhe “Shpenzime të tjera operative”.

Në shpenzime të tjera korrente artikulli 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, kërkesat janë parashikuar në shumën 1,500 mijë lekë, kërkesa të cilat konsistojnë në parashikimin e shpenzimeve për rimbursimin e pagesës sipas limitit të

shërbimeve telefonike, sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar.

Kërkesa buxhetore për shpenzime korrente, si për vitin 2025 ashtu edhe për vitin 2026, janë parashikuar në shumën prej 343,000 mijë lekë, ose 30,850 mijë lekë mbi tavanin e miratuar për vitin 2025 dhe 28,850 mijë lekë mbi tavanin e miratuar për vitin 2026.

Kalojmë në shpenzimet kapitale.

Në shpenzime kapitale (investime), artikulli 230 + 231 “Investime/Aktive afatgjata jomateriale dhe materiale”, janë parashikuar në shumën 134,300 mijë lekë, të cilat në mënyrë të detajuar krahasuar me tavanet janë në shumën 119,300 mijë mbi tavanet e miratuara.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike paraqiten sipas kodeve të projektit.

Kodi i Projektit – Blerje Pajisje – janë në shumën 134,000 mijë lekë. Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, janë programuar duke u bazuar në nevojat e kërkesat e identifikuar dhe të programuara nga Sektori IT, për blerje pajisje për transferimin e sistemit RDA nga AKSHI në KLGJ, për pajisje për instalimin dhe konfigurimin e serverëve, pajisje të tjera të tjera teknike, sistem “exchange” server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën IT të KLGJ dhe pajisje kompjuterike.

Nënartikulli “Pajisje kompjuterike”, janë programuar në shumën 8,450 mijë.

Kërkesat buxhetore për shpenzime kapitale (investime), si për vitin 2025 ashtu edhe për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 15,000 mijë lekë dhe janë në të njëjtin nivel me tavanin e miratuar nga KM.

Programi i dytë – “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, program i cili përfaqëson kërkesat buxhetore të QTI-së duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimin dhe objektivat strategjike të kësaj qendre, buxhet i cili është miratuar edhe nga bordi drejtues i QTI-së.

Edhe për këtë program është përcaktuar deklarata e misionit, qëllimi i politikës së programit, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektiv dhe produkti i programit.

Kërkesat buxhetore për vitin 2024 për këtë program janë në shumën 14,500 mijë lekë të cilat janë të gjitha shpenzime korrente, të ndara në shpenzime personeli, shpenzime operative dhe shpenzime për transferta për buxhetet familjare dhe individët, dhe krahasuar me tavanet përgatitore në shumën 12,900 mijë lekë, janë më shumë në shumën prej 1,600 mijë lekë. Ndërsa në shpenzime kapitale kërkesat janë parashikuar në 0 lekë për arsye që e gjithë mbështetja në bazë të Vendimit të KM i bëhet qendrës nga KLGJ (që do ta trajtojmë pak më vonë).

Kërkesat buxhetore në këtë program, në mënyrë analitike dhe detajuar në artikuj e nënartikuj, sipas natyrës së shpenzimeve paraqiten si më poshtë:

Në shpenzime korrente, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 14,500 mijë lekë, nga të cilat shpenzime paga janë në vlerën 10,300 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përgatitore të miratuara, në shumën 11,000 mijë lekë, janë më pak në shumën 700 mijë lekë.

Në artikullin 601, kërkesat janë në vlerën 1,600 mijë lekë, ndërsa tavanet janë 1,500 mijë lekë të cilët janë më shumë në vlerën 100 mijë lekë.

Në artikullin shpenzime operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 2,576 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përgatitore të miratuara, në shumën 376 mijë lekë, janë më shumë, në shumën 2,200 mijë lekë.

Nevojat për fonde buxhetore për këtë grup shpenzimesh konsistojnë në shpenzime të tjera operative që kanë të bëjnë me pagesat e honorareve të anëtarëve të bordit për mbledhjet e organizuara gjatë vitit buxhetor, për materiale zyre e të përgjithshme, shërbime nga të tretët, shpenzime udhëtimi, etj.

Ndërsa, për sa i përket shpenzime të tjera korrente, artikulli 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 24 mijë lekë dhe janë në të njëjtën shumë me tavanet përgatitore dhe konsistojnë me pagesën e shpenzimeve të telefonisë celulare sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Kërkesat buxhetore për shpenzime korrente për vitin 2025 janë parashikuar në shumën 15,300 mijë lekë dhe për vitin buxhetor 2026, në shumën 16,000 mijë lekë.

Duke qenë se në detajimin e fondeve buxhetore në shpenzime korrente në këtë program në shpenzime personeli tavanet janë më të larta, kjo do jetë objekt diskutimi në takimin negociues që do kemi me Ministrinë e Financave për të sistemuar këto diferenca gjatë takimit negociues për fazën e parë strategjike që do zhvillohet në fund të majit pranë Ministrisë së Financave.

Programi 3310 – “Buxheti gjyqësor”-

Në këtë program, e cila siç e theksova dhe më lart, zë pjesën më të madhe të buxhetit të sistemit gjyqësor, përfshihen kërkesat buxhetore për mirëfunksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Edhe për këtë program është përcaktuar përshkrimi i politikës së programit, qëllimi i politikës së programit, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektivi si dhe produktet e programit të cilët janë të ndara sipas grup shpenzimeve (shpenzime korrente dhe në shpenzime kapitale).

Shpenzime korrente produkti është: çështje të gjykuara ndërsa shpenzimet kapitale kanë produkte, blerje pajisje zyre, blerje pajisje elektronike, studime dhe projekttime, ndërtim godinë e re/rikonstruksione, blerje mjetesh motorike, programe për “software”.

Më poshtë është pasqyra që ju e keni të gjithë parasysh dhe po i referohem pasqyrës në lidhje me kërkesat buxhetore, ku për vitin 2024, në këtë program janë parashikuar në shumën 6,201,000 mijë lekë në total të cilat janë të ndara në shpenzime korrente në shumën 4,358,900 mijë lekë dhe shpenzime kapitale në shumën prej 1,842,100 mijë lekë, krahasuar me tavanet e miratuara në shumën prej 3,546,600 mijë lekë, paraqiten rreth 75% më e lartë se taveri i miratuar ose në vlerë absolute në shumën prej 2,654,400 mijë lekë më shumë, nga të cilat 1 miliard zënë kërkesat buxhetore për shpenzime korrente, përfshirë këtu edhe kërkesën për shtesën prej 55 punonjësish për administratën gjyqësore dhe kërkesën për 25 punonjës me kontratë.

Në shpenzime kapitale kërkesa është 1,842,100 mijë lekë, ose rreth 8 herë më e lartë se taveri i miratuar.

Kalojmë në paraqitjen analitike të grup shpenzimeve. Në shpenzime korrente, siç e theksova janë në shumën 4,358,900 mijë lekë, të cilat janë të ndara në shpenzime

personeli të cilat janë në shpenzime pagash dhe shpenzime sigurime shoqërore, si dhe shpenzime për transferta dhe buxhete familjare dhe individë.

Kërkesa për shpenzime personeli, në artikullin 600 “Shpenzime për paga”, janë parashikuar në shumën 3,321,700 mijë lekë. Programimi i kërkesave buxhetore për shpenzime të pagave, gjatë fazës së parë, është bërë duke u bazuar në numrin e punonjësve sipas strukturës organizative, numrin shtesë të kërkuar si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi për caktimin e strukturës organizative të pagave të magistratëve si dhe ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe treguesve të tjerë të cilët kanë të bëjnë me numrin në total të punonjësve të sistemit gjyqësor të miratuar me ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, që është 1759, i ndarë në 1625 punonjës të administratës gjyqësore dhe 408 janë magistratë. Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në muajin mars 2023, numri i organikës në fakt, për gjykatat e të gjitha niveleve, rezulton të jetë 1345, nga të cilët 307 magistratë sipas organikës në fakt dhe 1038 administratë gjyqësore.

Gjithashtu, në parashikimin e kërkesave buxhetore për fonde në shpenzime personeli jemi bazuar edhe në disa tregues të tjerë të sjellë nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe të cilat kanë të bëjnë me parashikimin e 32 kandidatë për magistrat, profili gjyqtar, të cilët pritet të përfundojnë Shkollën e Magistraturës në vitin 2024. Në vitin 2025 rezultojnë 44 kandidatë për magistrat, profili gjyqtar, të cilët pritet të përfundojnë Shkollën e Magistraturës. Për vitin 2026 vijon procesi i verifikimit të kushteve për kandidatët referuar vendimit nr. 53, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, projeksion për vitin akademik 2023-2024, numri i kandidatëve për magistrat, profili gjyqtar, është 40 pozicione. Ndërsa referuar të dhënave për kancelarët në detyrë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor aktualisht janë kualifikuar dhe lejuar për marrë pjesë në provimin e formimit profesional, gjithsej 16 kancelarë në detyrë.

Diferenca në shpenzime personeli vlerësojmë se duhet të merret në konsideratë pasi bazuar në vendimin 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese ka ndryshuar paga referuese për magistratët gjyqtarë e cila sjell një efekt të konsiderueshëm në rritjen e shpenzimeve të pagave në sistemin gjyqësor. Gjithashtu, në vendimin nr. 147/2023, të Këshillit të

Lartë Gjyqësor, “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, është bërë kategorizimi i gjykatave, dhe rrjedhimisht ka ndryshuar edhe niveli i pagave duke iu referuar zbatimit të VKM nr. 919/2020 për pagat e administratës gjyqësore. Zbatimi i kësaj VKM–je sjell rritje të pagave për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe në përgjithësi për buxhetin gjyqësor.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj, se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kërkuar gjatë këtij viti buxhetor, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, fonde shtesë në shpenzime personeli për vitin buxhetor në vazhdim 2023, në shumën 710,000 mijë lekë për mbulimin e efektit financiar të ndryshimit të pagës referuese të gjyqtarit për periudhat 01.01.2019 – 28.05.2021 dhe për vitin buxhetor 2023, si rezultat i zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Jemi në pritje të miratimit të fondeve shtesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kjo shumë prej 710,000 mijë lekë, nuk është bërë pjesë e kërkesave tona buxhetore në këtë fazë, pasi jemi në pritje të miratimit të tij nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, situatë e cila do të vlerësohet në fazën e dytë të përgatitjes së dokumentit të PBA-së për sistemin gjyqësor. Kjo situatë do të diskutohet edhe në negociatat që do të zhvillohen nga përfaqësuesit e KLGJ-së në Ministrinë e Financave, në muajin maj, për fazën e parë të përgatitjes së projektbuxhetit 2024-2026.

Në artikullin 601 “Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore” janë parashikuar në shumën 415,300 mijë lekë, të cilat janë parashikuar duke u përllogaritur sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu kërkesat buxhetore për shpenzime korrente për vitin 2025 janë parashikuar në shumën prej 4,580,000 mijë lekë dhe për vitin 2026, janë parashikuar në shumën prej 4,715,000 mijë lekë.

Kalojmë në grup shpenzimet për “Mallra dhe shërbime të tjera”, që në gjuhën e zakonshme citohen si shpenzime operative, të cilat për programin 3310 janë në shumën 615,800 mijë lekë. Kërkesat buxhetore janë të njëjta me tavanin e miratuar. Këtu nuk kemi kërkesa buxhetore mbi tavanin.

Në mënyrë analitike, kërkesat buxhetore, sipas natyrës së shpenzimeve janë parashikuar të përdoren si më poshtë:

Nënartikulli “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, nënartikulli “Materiale dhe shërbime speciale”, nënartikulli “Shërbime nga të tretë”, ku është pjesa më e madhe e

shpenzimeve të cilat do të përdoren për shpenzimet e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë të godinave dhe ambienteve të të gjitha gjykatave; shërbimi i mirëmbajtjes të sistemit ICMIS të Gjykatës së Lartë dhe 19 gjykatave të tjera si edhe mirëmbajtja e sistemit ARKIT në dy gjykata (e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar); shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes, suport teknik për programin “m-files”, programin “sdml lot” dhe portalin “e-shërbime.klgj.al”; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit “audio RDA” nëpër sallat e gjyqit, si edhe mirëmbajtje dhe suport teknik për programin “Backup Chain”, i cili menaxhon ngarkimin e materialeve audio nga gjykata drejt serverit qendror; shërbimit të mirëmbajtjes të programit financiar për të gjithë sistemin gjyqësor; shërbimit të mirëmbajtjes së “server room” dhe “Licensa Firewall 6200 dhe 3800 Checkpoint”; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të aplikacionit “PAKS+”; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të aplikacionit “High Court Datacollection”; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të aplikacionit “Infopoint”; shpenzimet e shërbimit të Internet, Intranet për sistemin gjyqësor, lidhja “dark fiber”, “L2 internetit”; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të rrjetit të informacionit të klasifikuar në sistem.

Gjithashtu, në këtë grup shpenzimesh kemi edhe nënartikullin “shpenzime për transportin”, nënartikullin “shpenzime udhëtimi e dietash”, nënartikullin “shpenzime mirëmbajtje të zakonshme”, nënartikullin “shpenzime për detyrime dhe kompensime legale” ku pjesën më të madhe këtu janë vendimet gjyqësore të formës së prerë, dhe nënartikulli “shpenzime të tjera operative”.

Gjithashtu, në këtë grup shpenzimesh janë marrë parasysht edhe kërkesat buxhetore të ardhura nga Gjykata e Lartë në lidhje me fondin buxhetor për mirëfunksionimin e KED-së për vitin 2024, si shtesë në buxhetin e Gjykatës së Lartë në shumën 9,000 mijë lekë.

Kalojmë në shpenzime të tjera korrente në nënartikullin 606 – shpenzime për transferta për buxhete familjare dhe individë janë parashikuar në shumën 6,100 mijë lekë, të cilat janë parashikuar të përdoren për subvencionimin e kredisë për magjistratët përfitues të kredisë lehtësuese si dhe për rimbursimin e shpenzimeve të telefonisë celulare sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të dalë për këtë qëllim.

Gjithashtu për vitin 2025 shpenzimet korrente janë parashikuar në shumën 4,580,000 mijë lekë. Për vitin 2026, janë parashikuar në shumën 4,715,000 mijë lekë.

Kalojmë në shpenzimet kapitale (investime), artikulli 230 dhe 231.

kërkesa buxhetore për vitin 2024 në këtë grup shpenzime janë parashikuar në shumën 1,842,100 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh janë parashikuar bazuar në kërkesat e ardhura nga të gjitha gjykatat, databazës që disponon struktura përgjegjëse për investime në KLGJ, kryesisht për studime-projekttime, ndërtime, rikonstruksione, pajisje të ndryshme IT, orendi dhe pajisje mobilie zyre, mjete transporti dhe pajisje të tjera teknike si dhe të gjitha nevojave të identifikuar nga Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit në KLGJ për programe “software” për gjykatat e të gjitha niveleve.

Të ndara në artikuj dhe të detajuara sipas kodeve të projekteve, kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimi paraqiten si më poshtë:

Artikulli 230 “Investime/aktive afatgjata jo materiale” janë parashikuar në shumën 66,800 mijë lekë, dhe të gjitha këto janë në kodin e projektit “Studime dhe projekttime”, të cilët janë parashikuar për studime, projekttime për ndërtimin e godinave të reja për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Durrës, Tiranë, Lezhë dhe Kukës. Gjithashtu, kërkesa buxhetore është parashikuar edhe për Gjykatën e Krimeve të Rënda, në shumën 2,000 mijë lekë për hartimin e projektit për instalimin e sistemit të ri “BMS” të menaxhimit të godinës.

Artikulli 231 “Investime/aktive afatgjata materiale”, në vitin e parë buxhetor, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 1,775,300 mijë lekë duke u bazuar në projektet për ndërtimin e godinave të shtrira në disa vite buxhetore, sipas madhësisë së gjykatës.

Në kodin e projektit “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 997,600 mijë lekë. Në nënartikullin “Ndërtime (ndërtesa administrative)”, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 816,000 mijë lekë dhe konsistojnë në: ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë që siç dihet për vitin 2023 është alokuar fondi prej 30,000 mijë lekësh për hartimin e projektit të zbatimit dhe

urojmë që kjo të realizohet dhe me realizimin e saj parashikohet fillimi i punimeve për vitin 2024 në shumën 450,000 mijë lekë, vijimi i tij në vitin 2025 dhe 2026 në shumat respektive.

Sqarojmë se, vlerat e mësipërme janë të përafërta dhe do të saktësohen pas hartimit të projektit të zbatimit, pjesë përbërëse e të cilit do të jetë dhe preventivi i punimeve të zbatimit, i cili do të përcaktojë shumën e saktë.

Dua të theksoj se për të gjitha grup shpenzimet sipas kodit të projekteve, bashkëlidhur janë edhe dokumentacioni shoqërues dhe argumentues për secilin projekt për të cilin janë paraqitur kërkesa për fonde buxhetore.

Gjithashtu në këtë nënartikull është parashikuar edhe ndërtimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku vlera totale e investimit të parashikuar është 603,000 mijë lekë.

Për vitin buxhetor 2023 është alokuar fondi në 20,000 mijë lekë, për hartimin e projektit të zbatimit për godinën e re të kësaj gjykate. Vlen të theksohet se ky projekt është pjesë edhe i planit të veprimit të zbatuar për strategjinë ndërsektoriale të drejtësisë 2021–2025 (përcaktuar në objektivin 2.4), miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.823, datë 24.12.2021.

Për vitin 2024–2026 është parashikuar që realizimi i projektit të investimit për godinën e re të Gjykatës së Apelit Tiranë, të fillojë në vitin 2024 në vlerën **303,000 mijë lekë** dhe të vijojë për vitet buxhetore në vazhdim 2025 kur parashikohet edhe përfundimi i këtij investimi. Urojmë që të përfundojë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vlera totale e investimit është parashikuar në shumën 286,400 mijë lekë. Për vitin 2024 është parashikuar fondi prej 63,000 mijë lekësh, për vitin 2025 është parashikuar fondi 100,000 mijë lekë dhe përfundimi i këtij projekti investimi në 2026 është pjesa tjetër e investimit në shumën 123,400 mijë lekë.

Ndërsa, për vitin buxhetor 2025, parashikohen të ndërtohet (në rast miratimi dhe realizimi të projekteve të zbatimit për këto gjykata), dhe godinat e gjykatave të rrethit gjyqësor Berat, Durrës, Kukës, Lezhë, Tiranë. Ndërsa për vitin buxhetor 2026 parashikohet të fillojë ndërtimi i godinës së rrethit gjyqësor Shkodër, ku vlera totale e investimit është parashikuar në shumën 290.000 mijë lekë.

Kalojmë në nënartikullin 231.2118 “Rikonstruksione të tjera ndërtimore”, ku kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën prej 181,600 mijë lekë. Të gjithë këto kërkesa buxhetore për rikonstruksione kanë ardhur si rezultat i kërkesave të ardhura nga gjykatat. Kështu, Gjykata e Apelit Tiranë – Kërkesa buxhetore për këtë gjykatë janë parashikuar në shumën 112,990 mijë lekë.

Fondet e kërkuara nga gjykata nevojiten për realizimin e punimeve të rikonstruksionit në të gjitha ambientet e gjykatës për të mbështetur veprimtarinë e saj gjatë periudhës tranzitore deri në sigurimin e akomodimit të ri në shumën 95,152 mijë lekë. Gjithashtu ka paraqitur edhe një kërkesë për përshtatjen e dhomës së serverit, kërkesë e cila vjen në zbatim dhe në përputhje me “Standardet për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata”.

Gjithashtu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka kërkuar një fond për përshtatjen e dhomës së serverit në përputhje me dokumentin “Standarde për ndërtimin e dhomës së serverit”.

Për të njëjtin qëllim edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur kërkesë për përshtatjen e dhomës së serverit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka paraqitur kërkesë dhe janë parashikuar shuma prej 2,365 mijë lekë për rikonstruksionin e tarracës së godinës, e cila është evidentuar se ka dëmtime të shtresave të hidroizolimit.

Kërkesë ka paraqitur gjithashtu edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e cila ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë dhe është parashikuar shuma prej 44,345 mijë lekë për realizimin e punimeve të rikonstruksionit të godinës ekzistuese të gjykatës e cila vjen edhe si rezultat i riorganizimit të gjykatës dhe ambientet për pamjaftueshmëri ambientesh.

Kërkesë tjetër ka sjellë edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e cila është në shumën 13,000 mijë lekë, edhe kjo për përshtatjen e dhomës së serverit.

Kalojmë në kodin e projektit “Programe software për gjykatat”.

Kërkesat buxhetore për vitin 2024 për këtë kod projekti janë parashikuar në shumën 349,300 mijë lekë, të cilat konsistojnë në programe software, siç është programi për digjitalizimin e dosjeve të arkivit gjyqësor të cilat kanë filluar implementimin që në

vitin 2022; projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili është parashikuar të shtrihet për një periudhë 5–vjeçare, projekt i cili ka filluar të implementohet gjatë vitit 2023, për të cilin kemi detajuar shumën prej 212,000 mijë lekë. Për vitin 2024 ky projekt është parashikuar në shumën 310,700 mijë lekë dhe për vitin 2025 – 341,000 mijë lekë, për vitin 2026 në shumën 108,500 mijë lekë dhe për vitin e fundit 2027 është parashikuar në shumën prej 87,736 mijë lekë.

Gjithashtu, në kodin e projektit “Blerje pajisje elektronike”, kërkesat buxhetore për të janë parashikuar në shumën 76,600 mijë lekë. Këtu janë mbështetur në të gjitha kërkesat e ardhura për pajisje elektronike në të gjithë gjykatat.

Në këtë kod projekti përfshihen “instalime dhe pajisje telekomunikacioni”, “pajisje audio vizuale”, “pajisje të tjera teknike”, “pajisje fotokopje”, “pajisje kompjuterike” dhe “pajisje të tjera zyre”.

Kodi i projektit “Blerje pajisje të tjera zyre”, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 327,200 mijë lekë. Kjo vlerë është e përbërë nga nënartikujt “pajisje të tjera zyre”, nënartikulli “pajisje dhe instalim kondicioneri”, nënartikulli “pajisje për mbrojtje kundra zjarrit”, nënartikulli “pajisje për sistemin e sigurisë”, akses kontrolli, derë dedektimi, skaner bagazhesh, etj. Nënartikulli për “pajisje të sistemit të sigurimit” që është parashikuar në shumën 10,050 mijë lekë e cila nuk është parashikuar në projektin e sigurisë të gjykatave.

Gjithashtu, në këtë projekt është i përfshirë edhe projekti i sigurisë së gjykatave i cili ka filluar implementimin që në vitin 2023 dhe për vitin 2024 është parashikuar shuma 273,300 mijë lekë.

Nënartikulli “orendi zyre” e cila konsiston në parashikimin e kërkesave buxhetore për blerjen e pajisjeve të zyrave, tavolina, karrige, etazherë, dollapë, etj.

Kodi i projektit “blerje mjete motorike”, kërkesat buxhetore janë parashikuar në shumën 24,600 mijë lekë dhe konsiston në blerje automjetesh dhe motoçikletash.

Parashikimi i kërkesave buxhetore edhe për këtë kod projekti është bërë bazuar në kërkesat e ardhura nga gjykatat për automjetet, dhe konsiston në kërkesat e Gjykatës së Lartë dhe gjykatës së posaçme.

Për vitin 2025 kërkesat buxhetore në artikullin “Shpenzime kapitale” për programin 3310, janë parashikuar në shumën 2,063,600 mijë lekë, ndërsa për vitin 2026, janë parashikuar në shumën 2,043,400 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26) faza e parë, për sistemin gjyqësor, sipas relacionit të mësipërm dhe pasqyrave shoqëruese.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.
Faleminderit edhe një herë.

Ilir Rusi: Faleminderit z. Haxhiu!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhje nëse kanë ndonjë pyetje apo diskutim në lidhje me çfarë u raportua si relacion nga z. Haxhiu për buxhetin.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi miratimin e kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 (PBA 24–26), faza e parë, për sistemin gjyqësor (Këshillin e

Lartë Gjyqësor, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë dhe gjykatat), sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI–NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD– së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 6 të saj, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën ia jap z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, më datë 11.04.2023 ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për procedimin disiplinor ndaj magistratëve z. {...} dhe z. {...}, gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Kërkesa bazohet në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "d" e ligjit nr. 96/2016.

Në kërkesën e mësipërme Inspektori ka paraqitur propozimin për caktimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarit {...} për "Ulje të përkohshme të pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një viti, në referim të nenit 108 i ligjit "Për Statusin", ndërsa ndaj gjyqtarit {...} "Vërejtje publike", të parashikuar nga neni 107 i po këtij ligji.

Me vendimin nr. 172, datë 14.04.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas shortit, si relator jam caktuar unë.

Lidhur me faktet dhe rrethanat e pretenduara objekt procedimi jeni njohur.

Mbasi kam bërë verifikimin paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31 të rregullores për procedurën disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse jemi përpara ekzistencës së rasteve të parashikuara nga neni 139 të Ligjit "Për statusin", rezulton se hetimi disiplinor është filluar brenda afatit të parashkrimit 5-vjeçar, nuk rezulton që shkeljet e pretenduara të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor të zgjidhur me vendim të formës së prerë, nuk rezulton që të ketë arsye për të mbyllur procedimin disiplinor në përputhje me nenin 134, pika 1, shkronjat ç dhe d si dhe nenet 64 dhe 67 të ligjit "Për statusin". Janë rastet e nuk po zgjatem t'i citoj. Gjithashtu nuk jemi përpara rastit të kërkuar nga paragrafi i tretë i nenit 133, i ligjit "Për statusin", pasi raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar dhe plotëson të gjithë elementët formal të kërkuar nga paragrafi i nenit të sipërcituar.

Në mbledhjen e datës 24.04.2023 të Komisioni Disiplinor është vendosur pas relatimit nga ana e relatorit, kalimi i çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Si relator i çështjes, për sa më sipër relatova, meqenëse nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara për mbylljen e procedimit disiplinor, i propozoj mbledhjes kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore e cila duhet të zhvillohet brenda 1 muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori që është data 11.04.2023 dhe duhet pasur parasysh afati 15–ditor i njoftimit të palëve në referim të nenit 138 të ligjit “Për statusin”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Do doja propozimin tuaj në lidhje me datën dhe orën e mundshme.

Ridvan Hado: Unë propozoj që data të jetë 11 maj, ora 9:30.

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse kanë diskutime për sa u parashtrua nga relatori.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e datës 11.05.2023, ora 09:30, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratëve, z. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, vazhdojmë me shqyrtimin e pikës 7: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”,

për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën ia jap relatorit.

Dritan Hallunaj: Faleminderit i nderuar drejtues i seancës!

Atëherë, parashtroj relacionin për gjendjen faktike dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidatit për lëvizjen paralele, të z. {...}.

Është hapur nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor procedura për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, për të cilin ka kandiduar edhe z. {...} i cili ka qenë gjyqtar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e Këshillit nr. 92, datë 06.03.2023.

Në vijim janë kryer të gjitha procedurat nga ana e Këshillit, mbi njoftimin e relatorit, si dhe me veprimet e tjera procedurale të kryera nga ana e Këshillit, për të cilën nuk ka pasur ndonjë kundërshtim nga ana e kandidatit.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit të kritereve, vijojmë me kriterin e parë, atë të “Përvojës profesionale specifike minimale”. Duke pasur parasysh vendimin nr. 14/2023 të Ligjit për Statusin, në të cilin thuhet: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës përkatëse për pozicionin e lirë ...”, është bërë verifikimi dhe sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} ka përfunduar studimet për drejtësi në vitin 2000 dhe, më pas, në vitin 2004, ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës. Më vonë është emëruar gjyqtar në vitin 2003 ku ka kryer stazhin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në vijim në vitin 2004 është caktuar përfundimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku ka ushtruar detyrën. Pra vjetërsia e përgjithshme e ushtrimit të funksionit të magjistratit është 19 vjet.

Gjithashtu, për sa i përket përvojës specifike, sipas urdhrave të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier rezulton që kandidati për periudhën 2004 – 2010 ka qenë pjesë e seksionit civil; për periudhën 2011 – 2014 ka qenë pjesë e seksionit penal; për periudhën 2019 – 2021 ka qenë pjesë e seksionit penal, duke gjykuar çështje për të mitur; për

periudhën 2021 – 2022 ka gjykuar çështje gjyqësore të seksionit penal dhe civil, ndërsa prej datës 13.09.2022 e në vijim ka qenë pjesë e seksionit penal.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni rezulton që kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 14, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit.

Është verifikuar që zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu është verifikuar kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” dhe ka rezultuar që për z. {...} nuk vërtetohet që ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këto kushte, duke vlerësuar procedurën e verifikimit të plotë, nga ana e relatorit i është propozuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili me datën 03.04.2023, duke konsideruar të plotë procedurën ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hallunaj!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në

fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Fjala për relatorin.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Atëherë, në vijim të procedurave për verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjet paralele, sipas vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 18 janar 2023, u hapën 14 procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 12, 13 dhe 15, në fushën e të drejtës civile, për të cilat ka kandiduar edhe z. {...}, i cili është gjyqtar me detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Nga ana e Këshillit janë bërë të gjitha veprimet procedurale, duke vendosur fillimin e procedurës, caktimin e relatorit. Për çdo veprim është njoftuar kandidati i cili nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me sa është kërkuar.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit paraprak për tre kriteret, rezulton që për kandidatin z. {...} është verifikuar kriteri i përvojës profesionale specifike minimale. Rezulton që ky gjyqtar ka marrë titullin jurist në vitin 2000. Pastaj në vitin 2007, me Dekretin e Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Me vendim nr. {...}/2014 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Me vendim nr. 109, datë 04.11.2016 të Këshillit të Lartë Drejtësisë transferohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku ndodhet dhe aktualisht. Vjetërsia e përgjithshme në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite.

Në lidhje me përvojën profesionale specifike në pesë vitet e fundit është marrë informacioni dhe rezulton që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka gjykuar çështje si të natyrës civile dhe ato të natyrës penale. Kjo për faktin se në këtë gjykatë nuk ka pasur dhe nuk ka të ndara dhoma civile dhe penale dhe gjyqtarët e kësaj trupe gjyqësore gjykonin çështje civile dhe çështje penale njëkohësisht; për periudhën 2017–2022 ka gjykuar në të dy seksionet, civil dhe atë penal; gjithsej 2156 çështje civile ku përfshihen si çështjet e themelit, ashtu edhe kërkesat me natyra të ndryshme. Pra rezulton që

kandidati {...} të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike, në fushën e së drejtës civile, në pesë viteve të fundit.

Është verifikuar kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe ka rezultuar negative, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu për kandidatin z. {...} është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale dhe pas verifikimeve të bëra dhe dokumentacioni i administruar rezulton që nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këto kushte, relatori ia ka përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili në mbledhjen e datës 03.04.2023 ka vendosur që të delegojë çështjen në seancën plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës për lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin 12, 13, 15 të vitit 2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votim e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr.24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. **Brikena Ukperaj** (anëtare)
9. **Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr.24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 24, datë 18.01.2023, të

Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjala relatorit.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Po vijoj me relacionin e përgatitur për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}.

Me vendimet e datës 18 janar 2023 KLGJ ka vendosur të hapë 14 procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to me vendimin nr. 11, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin nr.24 procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Për këto ka kandiduar edhe magjistrati z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Pasi janë kryer të gjitha veprimet procedurale nga ana e Këshillit, duke u bërë e mundur fillimi i procedurës si dhe caktimi i relatorit, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim.

Po vijoj me rezultatet e verifikimit të tre kriterëve të kandidimit.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale” dhe rezulton që zoti {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në vitin 2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014. Me dekret të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 9240, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në janar 2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i kësaj gjykate. Vjetërsia e përgjithshme në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vjet.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit rezulton që z. {...}, që nga emërimi si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka gjykuar çështje si të natyrës civile dhe ato të natyrës penale. Kjo për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin si një gjykatë e vogël ka pasur një trupë gjyqësore të pa ndarë në dhoma

apo seksione civile dhe penale dhe si të tillë kanë gjykuar çështje civile dhe çështje penale njëkohësisht.

Pra rezulton që plotësohet edhe kriteri specifik mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe rezulton nga dokumentacioni që zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur që për z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës.

Në këto kushte duke e vlerësuar procedurën e verifikimit të plotë për zotin {...}, relatori i ka përcjellë rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 03.04.2023 ka vendosur ta përcjellë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 24, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhje në votim të projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr.17, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr.17, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr.17, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë

Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Me vendimet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është hapur procedura për lëvizjen paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 13 dhe nr. 17, për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Për këto dy pozicione ka kandiduar znj. {...} e cila është me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, aktualisht e transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pasi janë kryer veprimet procedurale nga ana e Këshillit duke deklaruar fillimin e procedurës së verifikimit, duke caktuar relatorin, për të cilin nuk ka pasur kundërshtime, është vijuar me rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe konkretisht për “përvojën profesionale specifike minimale”, rezulton që znj. {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Me të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 25.03.2009 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. Në vitin 2014, me vendim të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}. Me vendim nr. 97, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia e përgjithshme në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, rezulton që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, për 2018 – 2022 gjykata nuk ka qenë e organizuar në dhoma/seksione dhe si e tillë ka gjykuar çështje civile dhe penale. Plotësohet edhe ky kriter dhe rezulton që të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e të drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe rezulton që nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Për sa i përket kriterit të papajtueshmërisë ambientale janë kryer verifikimet dhe rezulton që nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këto kushte, duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit, relatori ia ka parashtruar rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky Komision më datë 03.04.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vendosur kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr. 17, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr.17, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13 dhe nr. 17, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5–17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja *znj. {...}* të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja *znj. {...}* të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën për relatorin z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka proceduar me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Një nga kandidatët ka qenë edhe zonja {...} e cila është gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, aktualisht e transferuar me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit të saj, nga ana e relatorit janë analizuar të gjithë aktet të cilët do të lejonin nëse janë plotësuar apo jo këto kriteret kualifikuese.

Kështu për kandidaten {...} është verifikuar kriteri i “përvojës minimale”, në respekt të ligjit i cili kërkon që: “Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr.500, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar. Theksoj se znj. {...} ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës dekretin nr. {...}, datë. 10.10.2012, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me

Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 23.01.2014, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjithashtu nga të dhënat e administruara rezulton që gjatë verifikimit, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr.500, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu kjo kandidatë rezulton të ketë administruar edhe dhënien e pëlqimit (për veten dhe familjarët e afërt) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016.

Gjithashtu nuk rezulton që ndaj kandidatës të jetë aplikuar ndonjë masë disiplinore, kriter skualifikues dhe pengues në vijueshmërinë e kandidimit të saj.

Gjithashtu nuk rezulton ndonjë shkak në bërë të të cilit të krijohen kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

Në tërësi, duke mos pasur asnjë shkak të krijuar gjatë procedurës së verifikimit të cilat do të pengonin në kandidimin e mëtejshëm të zonjës {...}, nga ana e relatorit dhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është investuar KLGJ-ja me projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësisht nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të

telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 500, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504 datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504 datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504 datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale. Një nga kandidatët të cilët ka marrë pjesë në kandidim për këtë pozicion është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Në kuadër të përcaktimit si relator, kam administruar aktet e nevojshme të cilat do të provojnë plotësimin e të gjithë kriterëve të nevojshme për vijimin e kandidimit të kësaj kandidateje për më tej.

Kështu është verifikuar kriteri i “përvojës profesionale” dhe nga të dhënat rezultojnë që gjatë verifikimit deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, kjo kandidate të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuadër theksoj se kandidatja {...} ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 10.11.2011, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 23.01.2014, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Nga të dhënat e administruara rezultojnë që ajo të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale dhe nuk verifikohen të ketë kriteret e tjera ndaluese, siç është kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” apo “masë disiplinore” të aplikuar ndaj saj në fuqi.

Kështu që në këto kushte, nga ana e relatorit u procedua me përpilimin e

relacionit dhe investimin e Komisionit dhe të Këshillit me projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 13 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën z. Toro si relator.

Alban Toro: Në kuadër të përpjekjeve për plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor por në veçanti në gjykatat e apelit, nga ana e Këshillit, më herët është proceduar me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 ku është filluar procedura e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e së drejtës penale, si Gjykatën e Apelit Korçë në fushën e së drejtës penale.

Një nga kandidatet është edhe zonja {...}, për të cilën nga ana e relatorit është administruar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që do të provonte plotësimin e kriterëve formale për vijim më tej pastaj të kandidimit të saj.

Nga ana e të dhënave rezulton që zonja {...} ka filluar detyrën me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7155, datë 10.11.2011, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8460, datë 23.01.2014, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Nga të gjithë të dhënat rezulton që kandidatja {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara rezulton që kjo gjyqtare të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale, parashikime këto që rezultojnë nga neni 47/4 të ligjit “Për statusin”.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara nuk rezulton të ketë kritere ndaluese apo shkaqe ndaluese siç është verifikimi i një mase disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, kritere ndaluese të parashikuara nga nenet 8/3, 48/8, të ligjit “Për statusin”.

Kështu që, në këto kushte, duke mos pasur asnjë kriter apo shkak që do të ndalonte kandidimin e mëtejshëm të kandidates {...}, nga ana e relatorit dhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës u përpilua projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |

6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
6. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
7. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën 14 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Fjala për relatorin z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Nga ana e Këshillit, me vendimet nr. 500, 501, datë 21.11.2022 kanë filluar procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, gjithashtu në të njëjtën gjykatë, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rezulton të jetë hapur edhe një pozicion tjetër. Pra në total 2 pozicione të lira. Gjithashtu me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 nga ana e Këshillit është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale.

Për të gjithë këto pozicione, një nga kandidatët ka qenë z. {...}, për të cilin nga ana e relatorit janë administruar të gjithë aktet e nevojshme që do të provojnë plotësimin e kriterëve formale dhe lejimin e kandidimit të tij.

Aktualisht nga këto akte rezulton që z. {...} të ketë mbi 7 vjet eksperiencë si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë. Konkretisht me dekretin nr. 8768, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu nga të dhënat rezulton që {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr.500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022 rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu, në kuadër të respektimit të nenit 48, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.95/2016, rezulton që ai të ketë dhënë edhe pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016, kriteret të nevojshme këto për kandidim.

Nuk rezulton të ketë shkaqe të tjera që të pengonin kandidimin siç është aplikimi i ndonjë mase disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, i cili përfaqëson një kriter ndalues i parashikuar nga neni 8/3 i ligjit “Për statusin”.

Kështu që, në kushtet kur nuk verifikohet një kriter ndalues për vijimin e kandidimit të zotit {...}, nga ana e relatorit është përpiluar projektvendimi përkatës dhe së bashku me KZHK-në është investuar Këshilli i Lartë Gjyqësor me këtë projektvendim, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500, nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 500, nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022 si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

102

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 26.04.2023 (Pika 15)***

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 15 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet

e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe propozimi konkret vijon të jetë në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë për plotësimin e vakancave në mënyrë të veçantë në gjykatat e apeleve.

Kështu, me vendimin nr. 502, nr. 504, datë 21.11.2022 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka filluar procedura e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale, si dhe në apelin Korçë në fushën e të drejtës penale.

Një nga kandidatët të cilët kanë kandiduar në këto pozicione ka rezultuar të jetë edhe zonja {...} dhe në cilësinë e relatorit kam administruar dokumentacionin e nevojshëm i cili do të provojë plotësimin e kriterëve të parashikuara nga nenet 8/3, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”.

Rezulton që {...} gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat është emëruar dekretin nr. {...}, datë 10.10.2012 të Presidentit të Republikës ku është caktuar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej me dekretin nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Nga aktet e administruara rezulton që znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, shkallës së dytë dhe si gjyqtare e komanduar.

Gjithashtu duke marrë për bazë urdhrat për ndarjen e gjyqtarëve në dhoma/seksione, apo informacionin e administruar nga Gjykata e Apelit Vlorë, gjyqtarja {...} për periudhën 20.06.2022 – 27.01.2023 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile dhe penale, pasi Gjykata e Apelit Vlorë në këtë periudhë nuk ka pasur ndarje në dhoma dhe seksione.

Pra në tërësi për këtë gjyqtare kandidate rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë shkaqe të tjera ndaluese siç është aplikimi i ndonjë mase disiplinore në fuqi apo papajtueshmëri ambientale, të tilla që do të pengonin vijueshmërinë e kandidimit të saj më tej.

Në këto kushte, nëpërmjet Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, relatori ka investuar KLGJ-në duke propozuar sipas projektit të paraqitur këtij relacioni, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502 datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 16 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin

e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Edhe ky relacion trajton kriteret e parashikuara për vendimin nr. 502, 21.11.2022 me anë të të cilit janë hapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e së drejtës penale. Kandidati në fjalë është zoti {...} aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me dekretin nr. {...}, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej me vendimin nr. {...}, datë 10.02.2017 të KLD-së caktohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Nga aktet rezulton që zoti {...} të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, kriter i kërkuar nga ligji dhe konkretisht neni 47, pika 4 e ligjit “Për statusin”.

Gjithashtu ai rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale si dhe nuk janë verifikuar kritere ndaluese të parashikuara përkatësisht nga neni 48/8 dhe 8/3 të ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht të “mospasjes së masës disiplinore” si dhe të verifikimit të ndonjë kriteri ndalues të “papajtueshmërisë ambientale”. Nga këto akte nuk rezulton që të vërtetohet për ndonjë situatë papajtueshmërie ambientale në rastin hipotetik të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në këto kushte, nga ana e relatorit dhe KZHK-së është investuar Këshilli i Lartë Gjyqësor me projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale

minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |

113

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 26.04.2023 (Pika 17)***

7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën 17 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të

Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale relacioni përkatës. Për më tej fjalën znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit z. Rusi!

Po vijoj me relacionin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të programit të vlerësimeve për vitin 2023 dhe përparësive të përcaktuara nga neni 171, pika 5 e ligjit “Për statusin”, në çdo rast kur nga organet e rivlerësimit kalimtar përcillen aktet e dosjes profesionale të gjyqtarëve të konfirmuar, duhet të fillojë me përparësi procedurën e gradimit.

Pranë Këshillit, në datën 13.03.2023 është përcjellë dosja me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarin {...}, për të cilin, KPK me vendimin nr. 613, datë 16.01.2023 ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Nga përmbajtja e dosjes personale të gjyqtarit dhe dosjes së dërguar nga organet e rivlerësimit, rezulton se zoti {...}, tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me dekretin nr. 9657, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës.

Sa më sipër, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, z. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në dy periudha të veçanta:

- (i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;
- (ii) Funkcionin e gjyqtarit për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë.

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, referuar kuadrit ligjor të kohës në nenin 14 të ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”, parashikohej se:

“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare, ku në pikën c) parashikohej që viti praktik aktiv është viti i tretë i kësaj shkolle me ndjekjen e

çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional)”.

Në vijim janë analizuar neni 19 i ligjit si dhe neni 20 i ligjit, në bazë të të cilëve rezulton se periudha e stazhit profesional e cila përbën vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në fakt ka qenë pjesë e programit të formimit fillestar dhe për pasojë vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës i nënshtrohej vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të z. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3–vjeçare të vlerësimit 2013–2016, rezulton se ai ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën 23.06.2016 deri 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë. Edhe nëse vitin 2016 do ta konsiderojmë vit të plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtarit përkon me 6 muaj e 7 ditë.

Lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 84, pika 1 dhe 2 të ligjit “Për statusin”, parashikohet se:

“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale...”

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 është parashikuar se:

“4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit”.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për z. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013–2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3-vjeçare, nuk mund të fillojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1–

vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Në kushtet kur gjyqtari pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit 2013–2016, procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit është e pamundur për të filluar, për sa kohë nuk plotësohet kushti i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit pas përfundimit të shkollës.

Neni 97, pika 3 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”. Referuar pikërisht Kodit të Procedurave Administrative të thirrur për zbatim nga ligji për qeverisjen dhe neni 41 të këtij Kodi rezulton parashikohet se: “ Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; ...”

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative që rregullon rastet dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ (në këtë rast jemi në diskrecion të organit) në lidhje me nenin 171, pika 5 të Ligjit “Për statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme (sipas edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Apelit Administrativ në rastet e tjera). Këto kushte janë:

1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;

2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar. Për efekt të vlerësimit ajo përfshihet për efekt të përvojës profesionale në kuadër të analizës që edhe më parë u bë nga relatori për

përvojën e përgjithshme profesionale të gjyqtarit, por jo kohë pune për efekt të vlerësimit;

3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional (për shkak se gjyqtari ka më pak se një vit), vlerësohet se procedura e vlerësimit etik dhe profesional për të nuk mund të fillojë, dhe për këtë arsye Komisioni ia ka paraqitur çështjen mbledhjes plenare, e cila ka kompetencën kushtetuese për të vendosur lidhur me vlerësimet.

Është hartuar projektvendimi përkatës, në pikën e parë të të cilit përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, pasi koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën e 2-të parashikohet njoftimi i vendimit gjyqtarit si dhe në pikën 3 të drejtën e ankimit ndaj aktit individual.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit znj. Ukperaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Me shqyrtimin e kësaj pike, janë shqyrtuar të gjitha pikat e kësaj mbledhjeje me këtë rend dite.

Nëse mund të ketë situata në lidhje me delegimin e gjyqtarëve në vijim do të njoftoheni për mbajtjen e një mbledhjeje online përsëri, duke u ndjekur e gjithë procedura korrekte e saj.

Këtë mbledhje me këtë rend dite e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2023)

Pika 18 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 14:53.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në vijimin e mbledhjes (çështjet 5-17) Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

18 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

(Pas fjalës së zotit Rusi i cili deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare, merr fjalën zoti Toro si më poshtë.)

Alban Toro: Më fal Kryetar!

Kemi një short.

(Bëhet fjalë për shortin lidhur me caktimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.)

Ilir Rusi: E shikoj, por unë nuk kam asnjë material përpara.

Alban Toro: Materiali ka kohë që ka ardhur dhe sot më duket u integrua në rendin e ditës.

Ilir Rusi: Patjetër i nderuar!

Edhe unë prandaj ju thashë, po të jeni të vëmendshëm ku ju thashë, që këtë mbledhje me këtë rend dite që kam përpara po e deklaroj të mbyllur. Në varësi të situatave, do të njoftoheni për mbledhje tjetër.

Unë jam në zyrë dhe nuk kam asnjë material për të relatuar.

Alban Toro: Edhe unë vëmendjes tënde i thirra kur bëra citimin që në rendin e ditës është integruar edhe një pjesë tjetër që ka lidhje me caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për çështje të veçanta. Në fillimet e mbledhjes u dakordësua nga të gjithë anëtarët e Këshillit (*përpara se të fillonte mbledhja plenare*), që të përfshihet për shkak të emergjencës së saj. Nuk e di çfarë procedure tjetër solemne të duhet për ta integruar.

Ilir Rusi: I nderuar, por unë si drejtues nuk kam një material ta lexoj. Nuk kam një material të sjellë nga nëpunësit për ta lexuar, që të di, sikundër kam lexuar me përpikëri rendin e ditës të deritanishëm (se edhe unë isha prezent në atë moment), unë nuk kam një material për ta lexuar rendin e ditës dhe të vazhdoj ndjekjen e hedhjes së shortit në raport me materialet përkatëse.

Alban Toro: Për kë e kërkon materialin? Për çështjen e caktimit të gjyqtarit në atë gjykatë, apo për ta përfshirë në rendin e ditës? Se nuk po e kuptoj. Se materiali ka ditë që ka ardhur.

Ilir Rusi: Po unë, nuk kam unë përpara. Më vijnë materialet nga nëpunësit.

Brikena Ukperaj: Sapo na ka ardhur një material. Në fakt thotë “Rikujtesë”.

Alban Toro: Është rifreskim, Briken. Është rifreskim.

Brikena Ukperaj: Po, “rikujtesë”, – thotë. Në 14:35.

Alban Toro: Sepse është ideja që mos të harrohet, për shkak se një personi do të duhet t’i verifikohet masa e sigurisë marrë në gjykatë. Kjo është emergjenca.

Brikena Ukperaj: Mirë, vazhdojmë. E kemi në e-mail.

Përderisa është materiali në e-mail.

Alban Toro: Sa të sqarojë solemnitetin Kryetari, mund ta vijojë verifikimin edhe më tej. S’ka problem.

Ilir Rusi: Dakord atëherë, hedhim në votim të vazhdojmë shqyrtimin e kësaj që u prezantua vetëm me materialet e dërguara deri tani në e-mail. Votoni!

Atëherë, ajo çfarë është shtruar për propozim, do vazhdojmë shqyrtimin e kësaj pike të relatuar nga z. Toro, sipas materialit që deri më tani është përcjellë vetëm me e-mail. Unë nuk kam një dokumentacion të përcjellë pranë meje si drejtues i seancës për të vazhduar që unë të lexoj pikën e rendit të ditës dhe të vazhdojmë më tej. Nëse ju jeni dakord që ne ta vazhdojmë materialin sipas dakordësisë që kemi bërë në një mbledhje paraprake të bërë ditën e sotme në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe e-mailit të dërguar, atëherë dakord, votojmë. Znj. Plaku!

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vazhdojmë edhe me shqyrtimin e çështjes të sapo prezantuar tani.

Z. Toro, për më tej fjala për ju në lidhje me relatimin e çështjes.

Alban Toro: Në mënyrë të sintetizuar po ju paraqes materialin i cili bën fjalë për një trajtim kërkesë për caktim gjyqtari në gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila ka paraqitur kërkesë e cila mban numrin 286–149, 286–331, 286–426, 286–136, përkatësisht për veprat penale të parashikuara nga neni 76–22 të K.Penal, neni 79/ë –25–22 të K.Penal, Dërgim për gjyq, si dhe neni 283/2 K.Penal (*lexohen 4 prej çështjeve.*)

Për këto çështje është i pamundur zbatimi i aplikimit të skemës së delegimit si dhe i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, për shkak të padobishmërisë së caktimit të një gjyqtari efektiv me kohë të plotë në këtë gjykatë. Kështu që, e vetmja mundësi mbetet zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Në këtë kuadër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju propozon që:

Për 7 (shtatë) çështje, për të cilat në 1 rast kërkohen nga 2 gjyqtarë, dhe në 6 (gjashtë) raste nga 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhet me short 5 (pesë) të tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Natyrisht në këtë short është parashikuar edhe përjashtimi i kryetarit në detyrë z. Ervin Sulaj, për të cilin nëse juve nuk keni propozim apo vërejtje, të vijojmë më pas me shortimin e çështjeve në fjalë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me hedhjen e shortit.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale (kërkesa nr. 286–331), gjyqtarja Gentiana Shukullari.

Për çështjen nr. 4, penale (kërkesa nr. 286–136), gjyqtarja Eglantina Mikani.

Për çështjen nr. 5, penale (kërkesa nr. 295–89), gjyqtarja Thomaidha Roça.

Për çështjen nr. 3, penale (kërkesa nr. 286–426), gjyqtarja Luljeta Kole.

Për çështjen nr.1, penale (kërkesa nr. 286–149), gjyqtarët Seladin Pysqyli dhe Eglantina Mikani.

Për çështjen nr. 6, penale (kërkesa nr. 295–140), gjyqtarja Gentiana Shukullari.

Për çështjen nr. 7, civile (kërkesa nr. 295–259), gjyqtarja Thomaidha Roça.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Me shqyrtimin edhe të kësaj pike, me dakordësinë e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë!

* * *

(Pika 18 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor